



PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **29.12.2022** me fillim në ora **10.00**. Këtë mbledhje e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Komunitete **z. Bajram Morina**.
Kryesuesi – Fillimisht përshëndetje për të gjithë, faleminderit për praninë tuaj, përshëndetje për shefin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim z.Lendrit Qeli dhe përfaqësuesit të OSBE-së. Ky është takimi i gjashtë për vitin 2022, për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

REND DITE

1. **Aprovimi i procesverballi nga mbledhja e kaluar;**
2. **Informatë rreth vizitave të realizuara në shkollat ku vijojnë komuniteti joashumicë;**
3. **Informatë nga ZKK-ja;**
4. **Të ndryshme;**

1. **Aprovimi i procesverballi nga mbledhja e kaluar;**

Kryesuesi – A ka dikush ndonjë vërejtje rreth procesverballit nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Unanimisht u aprovua procesverballi.

2. **Informatë rreth vizitave të realizuara në shkollat ku vijojnë komuniteti joashumicë;**

Kryesuesi – Kopjen fizike të informatës e keni para jush. Gjatë këtij muaji në cilësinë e kryesuesit të Komitetit për Komunitete dhe anëtarët e këtij komiteti; Shqipe Kryeziu, Edonita Kryeziu, Faton Ramadani, drejtori i DKA-së Avni Morina, kemi realizuar vizita në dy shkolla: Në shkollën fillore të mesme të ulët “Hamëz Thaqi” Xërxë dhe në shkollën fillore të mesme të ulët “Liria” Fortesë. Gjatë takimeve me drejtorët e këtyre shkollave, jemi njoftuar për vijueshmërinë e nxënësve të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian që është i knaqshëm dhe që janë të integruar mirë me nxënësit e komunitetit shumicë dhe trajtohen shumë mirë nga nxënësit e tjerë. Braktisje të shkollës nuk ka dhe për fat të mirë bashkëpunimi me prind të nxënësve është i shkëlqyeshëm. Falënderojmë drejtorin e DKA-së për mbështetje. Për pyetje rreth kësaj teme, lirisht mund ta merrni fjalën.

Shqipe Kryeziu – Faleminderit për informatën kryesues. Një përmirësim: Edonita e ka mbiemrin Berisha, jo Kryeziu. Faleminderit.

3. **Informatë nga ZKK-ja;**

Lendrit Qeli – Faleminderit kryesues. Të nderuar të pranishëm. Do t’i cekim disa prej projekteve kyçe që i kemi pas gjatë tërë vitit dhe mbylljen e tyre me sukses gjatë këtij viti. Raport me shkrim nuk kemi përgatitur sepse raportin përfundimtar e kemi publikuar web-sajtin e komunës. Zyra jonë çdo vit ka progres dhe jam shumë i kënaqur për bashkëpunime të ndryshme.

Para një jave e promovuam qendrën për komunitete me bazë në shkollë, i bashkëfinancuar me organizatën IOM, me vlerë 25.000 euro me të gjitha pajisjet moderne. E nisa me arsimin sepse për ne është top prioritetet kryesore. Menaxhimi i qendrave në gjithë republikën e Kosovës bëhet nga OJQ-të e ndryshme, te rasti ynë,

potenciale janë tri prej tyre dhe pas vitit të ri do t'i takojmë të flasim për qëndrueshmërinë financiare e tyre. Për ta përfunduar arsimin si sektor, për herë të parë në komunën e Rahovecit janë mbështetur 6 nxënës me bursa nga ministria e arsimit dhe një bursë për një student të vetëm që e kemi në universitet nga Drejtoria e Arsimit të komunës sonë.

Banimit ka qenë sfidë për komunën tonë, por jam i lumtur që edhe këtu kemi gjetur hapësirë në mbështetje për familjet e komuniteteve dhe për herë të parë kemi bashkëpunim me njërin prej organizatave të nivelit qendror “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve” në renovimin e 5 shtëpive, prej tyre 2 janë të ndërtuara prej fillimit.

Infrastruktura është njëra prej çështjeve që poashtu kemi patur një bashkëpunim të mirë në mes të kuvendit komunal të Rahovecit dhe MAPL-së. Sot në ora 14:30 bëhet përirimi i rrugës në lagjen e epërme, një lagje e banuar me të gjitha komunitetet joshumicë. Për fund, njëra prej pikave kryesore ka të bëjë me zhvillimin ekonomik të pjesëtarëve të komuniteteve përmes start-up bizneseve. Nga organizata IOM janë mbështetur dy start-up, një për pjesëtarët e komunitetit serb dhe një për pjesëtarë të komunitetit egjiptianë dhe jam i bindur që do ta lehtësojnë gjendjen e tyre në aspektin financiarë.

Për vitin 2023 na presin 3 dokumente të rëndësishme për zyrën tone (tre plane të veprimit).

1. Plani i veprimit për të zhvendosur;
2. Plani për riatdhesim dhe migrim;
3. Plani i veprimit për komunitetin Romë dhe Ashkali;

Këtu i kam vërejtjet e mia ndaj qeverisë, është plan qesharak. Prej vitit 2009 jam i angazhuar me strategji të tilla dhe kjo është strategjia më e keqe e mundshme. Qeveria me një buxhet astronomik, që gjithashtu edhe nëpër komuna duhet të jetë një buxhet i njëjtë, por në të vërtetë është një buxhet që i ngjan një raporti e jo një strategjie. Kjo është njëra prej arsyeve që komuniteti egjiptianë nuk është brenda kësaj strategjie. Në bashkëpunim me OSBE-në ne kemi kërkuar që komuna jonë ta drafton një plan të veprimit për të gjitha komunitetet dhe meqenëse sot do të vie ministri Elbert Krasniqi do të kërkoj direkt që të na jep një dritë të gjelbër se a na lejohet një gjë e tillë.

Për fund, viti 2023 do të jetë me punë dhe angazhime për ne, përfshirë këtu edhe funksionalizimin e qendrës që padyshim, besoj që OSBE do të na ndihmojë edhe në vitin 2023. Në fund, e falënderoj Dushanin dhe bashkëpunëtorët tjerë nga komuniteti serb për konstruktivitet.

Kryesuesi – Faleminderit Lendrit për këtë informatë të duhur. Nëse dikush ka ndonjë pyetje?... Vazhdojmë me pikën e fundit.

4. Të ndryshme;

Dushan Stojanoviç – Përshëndetje. Një pyetje për z.Lendrit, sa i përket kërkesës që e kemi parashtruar për vendosjen e “policëve të shtrirë” sepse jemi të merakosur nga njerëzit që vozisin shpejtë në lagje.

Lendrit Qeli – Faleminderit Dushan. Kjo çështje është diskutuar edhe një Këshillin për Siguri. Në fakt kanë qenë dy çështje që deri më tani nuk është bërë asgjë. Në atë rrugë ju e dini që ka patur intervenime nga MAPL-ja dhe pa përfunduar puna nuk mund të vendosen “policët e shtrirë” (pengesa) dhe do të vendosen, sepse është kompania e kontraktuar nga komuna për vendosjen e këtyre pengesave.

Problemi me ndriçim gjithashtu do të rregullohet shumë shpejt sidomos me projektin e ri “Smart City”.

Ramë Berisha – Përshëndetje për udhëheqësinë dhe anëtarët. Vërshimet e fundit nëntor-dhjetor që janë bërë, paraqesin rrezik nëse përroi në Lugë Xërxe mbeten në gjendjen e tanishme. I lus organet kompetente që ta gjejnë një zgjidhje, ta pastrojnë, ta rregullojnë atë rrugë nëpër të cilën kalon ajo sasi e madhe e ujit që eventualisht mos të bëjë dëme në vendbanime. Në vitin 2016 janë bërë vërshime të vazhdueshme, konkretisht në vendbanimin tim ka hyrë uji, është bërë intervenimi edhe pse me vonesë. Tani përsëri është e nevojshme të bëhet një rehabilitim i terrenit aty për siguri të vendbanimeve dhe fushave. Edhe në mbledhjen e kaluar 31 tetor e kam cekë një kërkesë për Zyrën për Komunitete dhe Kthim. Për dimrin që po vjen, mundësisht të na


ofroj ndonjë stufë për ngrohje sepse parashihet ftohë i madh, njëkohësisht reduktime të rrymës. Pasi jemi në prag të vitit 2023 të gjithë anëtarëve urime dhe suksese të vazhdueshme.

Lendrit Qeli – Sa i përket stufave që i përmendi z.Rama, është bërë një keqkuptim me iniciativën e fundit të Qeverisë që të kursejmë rrymë e të aplikojmë për stufa përmes E-Kosovës dhe dikush e ka shpërndarë si propagandë që kinse ka të bëjë me komunitetet joshumicë. Mundësia jonë si zyre posedon një buxhet modest që nuk kalon më shumë se 20.000 euro dhe me kod janë investime kapitale. Kështu, neve na pamundësohen aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me subvencione te pjesa sociale.

Kryesuesi – Faleminderit z.Lendrit. Nëse edhe dikush dëshiron ta marrë fjalën?... Nëse jo, po e përmbylлим takimin. Urime festat e fundvitit.

Mbledhja përfundoi: 11:45

Procesmbajtësi;


Albin Krasniqi

Kryesuesi i mbledhjes;


Bajram Morina